



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 2284, Prot.

Tiranë, më 03.05.2024

Lënda: Kthim përgjigje

**INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE**

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, përcjellë me e-mailin e datës 22.04.2024, regjistruar me numër rendor 21 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2284 prot., datë 22.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhur me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të një kopje të jetëshkrimit (CV) me të dhëna deri në emërimin e fundit për subjektet ish-magjistratë të listuar në kërkesë, bashkëlidhur gjeni një kopje të jetëshkrimit, me të dhënat publike të tyre.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, sa i përket ish- magjistratëve (gjyqtarë) znj. \_\_\_\_\_ i, znj. \_\_\_\_\_ nuk disponojmë informacion të plotë lidhur me zhvillimin e karrierës së tyre, duke marrë në konsideratë që për këto subjekte procesi i rivlerësimit kalimtar është ndërprerë në vitin 2018 dhe në fillim të vitit 2019.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**RUDIN BAQLI**  
  


# Të dhënat e magjistratëve në sistemin gjyqësor

<b>Emër Mbiemër:</b>	Ergys Selmani		
<b>Gjykata ku ushtron detyrën:</b>	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier		
<b>Data e emërimit në detyrë:</b>	30/08/1995		
<b>Përvoja profesionale:</b>	Gjyqtar	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	13/05/2000 31/08/2021
	Ndihmësgjyqtar	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd	30/08/1995 13/05/2000
<b>Arsimimi:</b>	Cikli 4 vjecar	Universiteti i Tiranës	11/07/1995
<b>Kualifikime:</b>	Certifikata trajnimi nga Shkolla e Magjistraturës		
<b>Vlerësime Etike dhe Profesionale:</b>	Periodik	2005 - 2006	Mirë
	Periodik	2007 - 2009	Mirë
<b>Rivlerësimi kalimtar:</b>	Ndërprerje e procesit të rivleresimit kalimtar		